

"MANETCI" SH.P.K.

Nr. Prot

Tiranë, më 31.07.2019

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

Nr. Prot

Tiranë, më 31.07.2019

MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE:

"MANETCI" SH.P.K.

si Shoqëri Përthithëse

DHE

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

si Shoqëri e Përthithur

**"MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE "MANETCI" SH.P.K. DHE
"SKENDERBEJ" SH.P.K.**

Kjo marrëveshje lidhet sot, më datë 31.07.2019 në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. **SHOQËRIA "MANETCI" SH.P.K.**, person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në Njesinë Bashkiake Nr. 2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap. Nr. 3 dhe 4, Tiranë, e regjistruar në Regjistrimin Tregtar me datë 08 Gusht 2001, me NIPT K22203004A, përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Arben Memo, këtu e më poshtë referuar si **Shoqëria Përthithëse**;

dhe

2. **SHOQËRIA "SKENDERBEJ" SH.P.K.**, person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në rrugën e Kavajës, ish-Misto Mame, Tiranë, e regjistruar në Regjistrimin Tregtar me datë 31.07.1998 me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 19851, me NIPT J82003005H, përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Endrit Alikaj, këtu e më poshtë referuar si **Shoqëria e Përthithur**.

Palët bien dakord për sa më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë marrëveshje (duke përfshirë edhe anekset bashkëlidhur), përvec rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose përcaktohet ndryshe në vazhdim, fjalët e renditura më poshtë kanë këto kuptime:

"Marrëveshja"-do të thotë kjo Marrëveshje Bashkimi me Përthithje- duke përfshirë si pjesë integrale të saj edhe anekset bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje, të cilat janë nënshkruar dhe shkëmbyer ndërmjet shoqërive "MANETCI" sh.p.k. dhe "Skenderbej" sh.p.k. në fillim të procesit të përthithjes, si dhe pasqyrat financiare të "Skenderbej" sh.p.k të datës së mbylljes (31.07/2019):

"Mbyllja" do të thotë mbyllja e bashkimit mes "MANETCI" sh.p.k. dhe "Skenderbej" sh.p.k., si edhe më gjërësisht, nënshkrimi dhe shkëmbimi i të gjitha dokumenteve dhe përmbushja e plotësimi i të gjitha

2

"MANETCI" SH.P.K.

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

detyrimeve përkatëse që kërkohen të nënshkruhen, shkëmbehen, kryen dhe konsumohen në mbyllje sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje në mënyrë që bashkimi më përthitje të kryhet.

"Data e Mbylljes" do të thotë data 31.07.2019, në të cilën do të kryhet efektivisht mbyllja e procesit.

"Ligji Tregtar" do të thotë ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

"Data e Ekzekutimit" do të thotë data e regjistrimit të mbylljes në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

"Kodi i Punës" do të thotë Ligji Nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

"Regjistri Tregtar" do të thotë Regjistri Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

"Periudha Tranzitore" do të thotë periudha kohore nga data e nënshkrimit të marrëveshjeje deri në mbylljen e transaksionit të bashkimit me përthitje, gjatë së cilës "MANETCI" sh.p.k. dhe "Skenderbej" Sh.p.k. do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim përmblyshjen e transaksionit të bashkimit me përthitje.

"Aktivet dhe Detyrimet e Transferuara" do të thotë të gjitha aktivet dhe detyrimet e transferuara nga shoqëria e përthithur ("Skenderbej" Sh.p.k.) drejt Shoqërisë Përthithëse ("MANETCI" sh.p.k.), sic është përshkruar në këtë marrëveshjeje.

"Bilanci i Çeljes" do të thotë bilanci i shoqërisë përthithëse ("MANETCI" sh.p.k.) pas konsolidimit të bilanceve të shoqërive "MANETCI" sh.p.k. dhe "Skenderbej" Sh.p.k. në Datën e Fillimit të procesit (30.04.2019).

"Bilanci i Mbylljes" do të thotë bilanci i shoqërisë përthithëse ("MANETCI" sh.p.k.) pas konsolidimit të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara nga shoqëria e përthithur ("Skenderbej") në Datën e Mbylljes së procesit (31.07.2019).

Cdo dokument bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë dokumentat fillestare të procesit të përthithjes, Pasqyrat financiare të "Skenderbej" sh.p.k. të datës 31.07.2019, anekset analitike të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara, fatura tregtare e transferimit, përbëjnë pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje dhe kanë të njëjtën fuqi ligjore dhe efekt si kjo marrëveshjeje.

2. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë "Skenderbej" Sh.p.k. nga shoqëria "MANETCI" Sh.p.k., duke realizuar të gjitha procedurat e kerkuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi. "Skenderbej" Sh.p.k. (shoqëria e përthithur) do të përthithet nga "MANETCI" Sh.p.k. (shoqëria përthithëse) sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje hartohet në përputhje me nenin 216, pika e 1 e Ligjit tregtar. Aktualisht, shoqëria përthithëse "MANETCI" Sh.p.k. ushtron veprimtari tregtare për më tepër se 1(një) vit dhe zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "Skenderbej" Sh.p.k., pra është shoqëri mëmë e kësaj shoqërie. Sipas parashikimeve dhe në përputhje me nenin 215, pika 1 e Ligjit Tregtar, "Skenderbej" Sh.p.k. do të transferojë të gjitha aktivet dhe detyrimet tek shoqëria përthithëse "MANETCI" sh.p.k., e cila siguron dhe

"MANETCI" SH.P.K.

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

garanton respektimin ne vijimesi te kushteve të të gjitha kontratave ekzistuese të nënshkruara nga "Skenderbej" Sh.p.k. Bazuar në nenin 220, paragrafi 3 të Ligjit Tregtar, pas regjistrimit të bashkimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), shoqëria "Skenderbej" Sh.p.k. si një shoqëri e vecantë do të vlerësohet e prishur, ndërsa "MANETCI" sh.p.k. do të jetë shoqëria përrthithëse, e cila do të vazhdojë të ekzistojë me emrin "MANETCI" Sh.p.k.

3. BILANCET NË CELJE DHE NË MBYLLJE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Bashkimi me përrthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të "MANETCI" sh.p.k. dhe "Skenderbej" Sh.p.k. të datës 30 Prill 2019 (Data e fillimit), si dhe cdo ndryshim në pozicionin financiar të shoqërive deri në datën e mbylljes.

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përrthithëse ("MANETCI" Sh.p.k.) do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës 30 Prill 2019 të të dy shoqërive përpara përrthithjes.

"MANETCI" sh.p.k. do të përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e mbylljes, në bazë të pasqyrave financiare të kësaj date, të përgatitura nga "Skenderbej" Sh.p.k. dhe të miratuara nga Asambleja e Ortakut të vetëm.

AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUARA

Në bazë të nenit 215, pika 1 e Ligjit Tregtar, shoqëria "Skenderbej" Sh.p.k. do t'i transferojë Shoqërisë përrthithëse "MANETCI" Sh.p.k., kundrejt investimit të kësaj të fundit, të gjitha aktivet dhe pasivet sipas Bilancit të Datës së Mbylljes 31.07.2019.

Aktivet dhe pasivet përrfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare të datës 31.07.2019 (pjesë integrale e kësaj marrëveshje), listën klientëve, të furnitoreve, të drejtat dhe detyrimet tatimore, të drejtat dhe detyrimet ndaj shoqërisë mëmë, bazën e të dhënave të kontabilitetit, dokumentacionin kontabël të 10 viteve të fundit, të gjitha listëpagesat e punonjesve, kontratat e punës dhe të tjera kontrata, etj.

Me transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, "MANETCI" Sh.p.k. do të marrë në posedim të gjithë evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet dhe dokumenta të tjerë për të provuar ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që transferohen.

Për aktive/detyrime të caktuara për transferimin e të cilave mund të nevojitet miratimi i një pale të tretë, janë marrë paraprakisht miratimet.

Në datën e hartimit të këtij dokumenti, por edhe në datën 31.12.2018, shoqëria "Skenderbej" Sh.p.k. nuk dispononte pasuri të paluajtshme dhe as inventarë qarkullues.

4. RAPORTI I KËMBIMIT TË KUOTAVE

Në përputhje me natyrën e transaksionit dhe në kushtet që shoqëria "MANETCI" Sh.p.k. është zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë "Skenderbej" Sh.p.k. , pra ortak i vetëm i kësaj shoqërie, nuk është e zbatueshme dispozita për kalkulimin e raportit të këmbimit të kuotave të shoqërive të përfshira në bashkim, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen, pasi "MANETCI" Sh.p.k. ishte dhe mbetet ortak i vetëm dhe të gjitha aktivet dhe detyrimet e transferuara, i përkisnin edhe para transferimit. Meqenëse shoqëria e përthithur është një shoqëri e kontrolluar 100% nga shoqëria përthithëse, bashkimi i shoqërisë mëmë me njësinë e kontrolluar plotësisht prej saj nuk është një kombinim biznesi, pasi shoqëria mëmë dhe njësia e kontrolluar prej saj përbënin një njësi të vetme ekonomike, edhe para se ato të bashkoheshin.

5. KUOTAT E SHOQËRISË PËRTHITHËSE

Referuar përcaktimit në pikën 4 më sipër, shoqëria "MANETCI" Sh.p.k. nuk ka detyrim për të emetuar kapital, pasi ajo është vetë zotëruese e kapitalit të shoqërisë së përthithur, kapital i cili së bashku me rezervat dhe një pjesë të fitimit të pashpërndarë, në konsolidim do të mbyllen nga vlera e investuar nga kjo kompani (vlera e paguar në datën e blerjes) referuar Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr.3, Kombinimet e Biznesit dhe shenimit 1, të tabelës nr.1 të raportit të hollësishëm . Pra vlera e regjistruar e kapitalit të shoqërisë "MANETCI" Sh.p.k., pas bashkimit do të jetë 689,750,000 Lekë, aq sa ishte para bashkimit. Struktura e ortakërisë mbetet e pandryshuar, ajo është e njëjte me atë para bashkimit dhe kapitali i përket shoqërisë "BALFIN" sh.p.k.

6. KUSHTET E MBYLLJES SË BASHKIMIT

Përfundimi i plotë i transaksionit të përthithjes i është nënshtruar përmbushjes së kushteve të mëposhtme përpara mbylljes:

- Asambleja e Ortakëve duhet të ketë miratuar këtë marrëveshje dhe dokumentet e tjera në lidhje me të, në përputhje me Nenin 218 të Ligjit tregtar ;
- "MANETCI" Sh.p.k. nuk ka nevojë për ndonjë licencë të veçantë, për të përthithur ato transaksione tregtare të transferueshme në datën e kësaj marrëveshje;
- Duhet të jetë hartuar plani për kompletimin e kontratave të punës me punonjësit e transferuar;
- Që bashkimi të konsiderohet i mbyllur duhet, gjithashtu, të jenë bërë njoftimet e Palëve të Treta.

Deri në, ose në datën e mbylljes palët duhet të bëjnë të mundur që dokumentat e mëposhtme të firmosen (/miratohen) dhe dorëzohen si mëposhtë:

- Marrëveshja finale e bashkimit me përthithje;
- Një kopje e vërtetuar e statutit të shoqërisë përthithëse, nëse do të ketë ndryshime (e pa aplikueshme për rastin);

5

- Letra e Dorëheqjes së administratorit të "Skenderbej" dhe e të zgjedhurve të tjerë (nëse ka);
- Një kopje e vendimeve të Asamblesë së ortakëve, gjatë së cilës janë miratuar mbyllja e transaksionit të bashkimit me përthitje, marrëveshje finale e bashkimit me përthithje dhe dokumentet e tjera në lidhje me të.

7. TË DREJTA TË VECANTA

Transferimi nuk prek të drejta të vecanta të ortakëve, pasi referuar statutit të secilës shoqëri, rezulton që nuk ka të tilla në datën e hartimit të kësaj kontrate.

8. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT

Në datën e regjistrimit të bashkimit në QKB, të gjitha kontratat e punës së punëmarrësve të "Skenderbej" Sh.p.k. në fuqi do të transferohen pranë "MANETCI" Sh.p.k. , në përputhje me Nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës. "MANETCI" Sh.p.k. do të marrë përsipër të gjithë kontratat e punës të punëmarrësve të "Skenderbej" Sh.p.k. dhe do të konsiderohet pala përgjegjëse për çdo detyrim të pashlyer nga "Skenderbej" Sh.p.k. para datës së ekzekutimit (si dhe për çdo detyrim tjetër).

9. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE TË "MANETCI" SH.P.K. PAS PËRTHITHJES

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të "MANETCI" Sh.p.k. Administratori dhe punonjës të tjerë të emëruar në funksione drejtuese tek "Skenderbej" Sh.p.k. do të japin dorëheqjen në Datën së Ekzekutimit.

10. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT

Sikurse parashikon neni 220, pika 3, e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit:

- a) ka pasojë kalimin te shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve, detyrimeve të shoqërisë që përthithet;
- b) Meqenese shoqëria përthithëse ishte ortak i shoqërisë së përthithur, nuk ka nevojë për ndryshim në strukturën dhe përbërjen e kapitalit të shoqërisë "MANETCI" Sh.p.k;
- c) bën që shoqëria "Skenderbej" Sh.p.k. që përthithet, të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personalitet juridik do të vazhdojë të ketë vetëm shoqëria përthithëse "MANETCI" Sh.p.k. e cila mban përgjegjësi të plotë për transaksionet para dhe pas transferimit në zbatim të legjislacionit në fuqi.

"MANETCI" SH.P.K.

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

11. MBROJTJA E KREDITOREVË

Kreditorët e shoqërive mbrohen në përputhje me nenin 221 të Ligjit Tregtar.

12. TE DREJTAT DHE DETYRIMET TATIMORE

Në datën e mbylljes së përthithjes, të drejtat dhe detyrimet tatimore të shoqërisë Skenderbej sh.p.k. janë si vijon:

Skenderbej sh.p.k.	31.07.2019	Shenime
Tatim mbi te ardhurat personale	0	Jane paguar detyrimet e 06.2019 dhe jane transferuar punonjesit
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	0	Jane paguar detyrimet e 06.2019 dhe jane transferuar punonjesit
Tatim mbi fitimin	2,828,425	E drejte ndaj shtetit (per tu transferuar nga administrata tatimore tek Mane TCI)
Total	2,828,425	

13. LIGJI I ZBATUESHEM DHE FORCA MADHORE

Kjo marrëveshje, në tërësi, do të qeveriset nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

14. TE NDRYSHME

• Shpenzimet

"MANETCI" Sh.p.k. do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet në lidhje me negocijimet, zbatimin dhe mbylljen e cdo dokumenti ligjor të nevojshëm për përthithjen.

• Ndryshime në Marrëveshje

Cdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga palët.

• Pavlefshëmëria e Pjesshme

Në rast se një pjesë e kësaj marrëveshjeje është/ose shpallet e pavlefshme ose jo detyruese, pjesa tjetër mbetet e vlefshme dhe e detyruese për palët.

• Gjuha

Kjo marrëveshje është hartuar në gjuhën Shqipe.

"MANETCI" SH.P.K.

Përfaqësues Ligjor

"SKENDERBEJ" SH.P.K.

Përfaqësues Ligjor

Tiranë, më 31.07.2019



RAPORT I HOLLËSISHËM

BASHKIMI ME PËRTHITHJE I SHOQËRIVE:

MANE TCI SHPK
si Shoqëri Përthithëse
DHE
SKËNDËRBEJ SHPK
si Shoqëri e Përthithur

Tabela e Përmbajtjes

I.	Deklarata Paraprake dhe Qëllimi i Bashkimit	3
II.	Forma Ligjore e Bashkimit dhe Përshkrimi i Procedurës për Bashkim.....	3
III.	Përshkrimi i dy Shoqërive të Përfshira në Bashkim dhe Struktura e Ortakërisë.....	5
IV.	Bilanci në celje dhe në mbyllje të bashkimit me përthithje.....	6
V.	Aktivitet dhe pasivet e transferueshme.....	6
VI.	Raporti i Këmbimit të Kuotave.....	7
VII.	Pasqyrat Financiare pas Bashkimit.....	7
VIII.	Të Drejta të Vecanta.....	7
IX.	Kushte të tjera Paraprake për Bashkimin me Përthithje.....	10
	i.Inventarizimi fizik i pasurisë.....	10
	ii.Organigrama e re	10
	iii.Plani Operacional dhe Pritshmëritë Ekonomike	10
	iv.Statuti i Ndryshuar.....	10
	v.Njoftimi dhe/ose Marrja e Pëlqimit nga Palë të Treta.....	11
X.	Kushte të tjera paraprake për bashkimin me përthithje.....	10
XI.	Efektet mbi Punëmarrësit	11
XII.	Efekte mbi Organet Drejtuese të shoqërisë Mane TCI Pas Përthithjes.....	11
XIII.	Efektet Ligjore të Bashkimit.....	11

I. DEKLARATA PARAPRAKE DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

- Në datën 20.06.2019, Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm të shoqërisë Mane TCI shpk me NIPT K22203004A, vendosi fillimin e procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Skëndërbej shpk (shoqëria e përthithur) me NIPT J82003005H, tek shoqëria Mane TCI shpk (shoqëria përthithëse) dhe njëkohësisht shoqëri mëmë e shoqërisë Skëndërbej shpk.
- Në përputhje dhe zbatim të vendimit të mësipërm, Mane TCI shpk dhe shoqëria Skëndërbej shpk do të bashkohen nga ana ligjore dhe organizative. Për këtë qëllim Mane TCI shpk dhe Skëndërbej shpk do të integrohen në një person juridik të vetëm ("Transaksioni i Bashkimit").
- Qëllimi i këtij bashkimi është rritja e konkurrueshmërisë, rendimentit dhe përfitimi i një efekti sinergjik, ulja e kostove dhe shfrytëzimi më efektiv i burimeve, përmirësimi i pozicionit në treg dhe si rezultat rritja e të ardhurave dhe fitimit për Kuotë.
- Duke qënë se 100% e Kuotave të Skëndërbej shpk zotërohen nga Mane TCI shpk, sukcesi i bashkimit me përthithje nuk rrezikohet nga faktorë të paparashikuar apo interesa të caktuara, që në këtë rast nuk ekzistojnë, apo edhe nga perceptimi i klientelës.
- Skema e bashkimit është në përfitim të Ortakut, punonjësve, kreditorëve.
- Periudha nga data e miratimit të projektit të bashkimit (nënshkrimi i projekt-marrëveshjes së bashkimit) deri në datën e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkimit do të jetë një periudhë tranzitore, gjatë së cilës Mane TCI shpk dhe Skëndërbej shpk do të marrin një sërë masash e do të plotësojnë disa kushte me qëllim përmbushjen me sukses të transaksionit të bashkimit me përthithje.

II. FORMA LIGJORE E BASHKIMIT DHE PËRSHKRIMI I PROCEDURËS PËR BASHKIM

Bashkimi i shoqërive me përthithje nënkupton transferimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të Skëndërbej shpk (shoqëria e përthithur) tek Mane TCI shpk (shoqëria përthithëse) në këmbim të Kuotave të kapitalit. Procedura që ndiqet për realizimin e bashkimit të shoqërive duhet të kalojë në dy faza kryesore procedurale, të cilat njoftohen dhe regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Faza e parë fillon me hartimin e një projekt-marrëveshje nga përfaqësuesit ligjorë të dy shoqërive. Projekt-marrëveshja midis palëve duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim;
- b) pranimi i palëve për kalimin e pasurive të shoqërisë që përthithet, në këmbim të Kuotave të shoqërisë përthithëse;
- c) raporti i këmbimit të Kuotave dhe çdo shumë e pagueshme në para;
- d) kushtet e ndarjes së Kuotave në shoqërinë përthithëse;
- e) të drejtat, që rrjedhin nga Kuotat në shoqërisë përthithëse;

- f) të drejtat, që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave apo të drejtave të veçanta të shoqërive të përthithura apo çdo mase tjetër në favor të tyre;
- g) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

Projekt marrëveshja e mësipërme është një kontratë, e cila përmban termat përfundimtare që u propozohet Ortakëve për nënshkrim. Duke qënë se termat mund të jenë shumë teknike dhe jo gjithmonë të thjeshta për t'u kuptuar, ligji detyron përfaqësuesit ligjorë të hartojnë këtë raport të hollësishëm i cili zbërthen dhe shpjegon projekt marrëveshjen e mësipërme në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë Ortakët e shoqërive.

Në këtë raport përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike të bashkimit, raporti i shkëmbimit të Kuotave apo të drejtave të vecanta, vështirësitë që janë hasur në përlllogaritjen e Kuotave apo të drejtave të vecanta me kapitalin e shoqërisë së re si dhe efektin e këtij bashkimi tek punëmarrësit.

Në rast se kërkohet nga të paktën një nga Ortakët e shoqërive, është e detyrueshme marrja e një eksperti i pavarur të fushës për të certifikuar termat e projekt marrëveshjes.

Eksperti harton një raport në të cilin shpreh vlerësimin e tij të pavarur mbi të gjitha çështjet e projekt marrëveshjes që janë të rëndësishme për pronarët e shoqërive në proces bashkimi.

Me qëllim që Ortakët të njihen me projekt marrëveshjen si dhe impaktin e saj, duhet që ajo të publikohet në faqen e internetit të shoqërive dhe të depozitohet në QKB të paktën 1 (një) muaj para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë që do të miratojë marrëveshjen.

Publikimi duhet të përmbajë këto dokumenta:

1. projekt marrëveshjen;
2. raportin e hollësishëm të përfaqësuesve ligjorë mbi projekt marrëveshjen;
3. pasqyrat financiare dhe ato të ecursisë së veprimtarisë të shoqërisë për të paktën tre vitet e fundit;
4. raporti i ekspertit, nëse ka;

Faza e dytë është ajo e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit në asambletë e shoqërive në proces bashkimi. Asambletë e shoqërive miratojnë marrëveshjen në kushtet e kuorumit dhe shumicës së cilësuar. Në asamble duhet të marrin pjesë ortakët që kanë më shumë se 50% të Kuotave me të drejtë vote dhe duhet të votojnë pro bashkimit dhe dokumentave respektivë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëmarrësve.

Në rastet kur projekt marrëveshja prek të drejta të vecanta të disa Ortakë atëherë duhet duhet ti nënshtrohet miratimit të Ortakë që preken.

Procesi i bashkimit me përthithje kërkon që shoqëria përthithëse të rrisë kapitalin në mënyrë që Kuotat e reja t'u shpërndahen Ortakë të shoqërisë së përthithur, por në këtë rast kjo dispozitë nuk është e vlefshme, pasi shoqëria Mane TCI shpk zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë Skënderbej shpk.

4 | F a q e

Pas miratimit të projektit të bashkimit në asambljetë e shoqërive, përfaqësuesit ligjorë të tyre njoftojnë organet tatimore dhe të gjitha palët e treta të interesuara për bashkimin. Kuadri i vlefshmërisë së bashkimit të shoqërive përmbyllet me marrjen e miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës (AK).

Ligji parashikon se AK duhet të njoftohet brenda 30 ditësh nga data e miratimit të bashkimit në asambljetë e shoqërive.

Përfaqësuesit ligjorë të tyre njoftojnë bashkimin për regjistrim në QKB. Vetëm pas këtij njoftimi në QKB mund të vijohet me zbatimin e :

1. transferimin tek shoqëria përthithëse e të gjithë asetëve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur;
2. kalimin e Kuotave të shoqërisë përthithëse në favor të Ortakëve të shoqërisë së përthithur.
3. ç'regjistrimin e shoqërisë së përthithur në QKB (pas regjistrimit të vendimit të asambleve në QKB, shoqëria e përthithur konsiderohet e prishur).

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të Ortakëve (nuk diskutohet kjo ceshtje në kete rast të përthithjes) dhe kreditorëve të shoqërisë së përthithur, ligji parashikon dispozita të vecanta në favor të respektimit të të drejtave të tyre. Kreditorët, kanë të drejtë që brenda 6 muajsh nga publikimi i vendimit në QKR të paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve dhe të kërkojnë garanci të mjaftueshme nga shoqëria përthithëse për kredite të tyre. Ligji konsideron garanci të mjaftueshme lëshimin e një deklarate me shkrim nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçantë deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit.

III. PËRSHKRIMI I DY SHOQËRIVE TË PËRFSHIRA NË BASHKIM DHE STRUKTURA E KAPITALIT

MANE TCI SHPK

Mane TCI shpk është regjistruar si person juridik më 07.08.2001 me adresë të selisë në Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap.nr.3, Tiranë, me kapital të regjistruar me vlerë 689 750 000 Lekë, e cila ushtron veprimtarinë ekonomike në projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vetë dhe për të treta, shitja e objekteve / njesive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira.

SKËNDËRBEJ SHPK


Skëndërbej shpk është regjistruar si person juridik më 03.08.1998 me adresë të selisë në Rruga e Kavajës, ish Misto Mame, Tiranë, me kapital të regjistruar me vlerë 21 832 888 Lekë, e cila ushtron veprimtarinë

ekonomike të shitjes Shitjes, blerjes dhe dhenien me qira e pasurive të paluajtshme etj, e cila gjatë vitit 2019 ka vijuar me mbylljen e transaksioneve normale të biznesit.

STRUKTURA E KAPITALIT TË DY SHOQËRIVE

Që nga data e blerjes me 08.02.2008 e në vijim, shoqëria Mane TCI sh.p.k. është ortak i vetëm i shoqërisë Skënderbej sh.p.k., pasi zotëron 100 % të Kuotave të kapitalit. Ky fakt lehtëson dhe përshpejton procesin e vendimarrjes lidhur me bashkimin me përthithje të shoqërive. Informacioni për pronësinë e kapitalit të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, gjendet në vijim:

Kapitali	Mane TCI shpk	Skënderbej shpk	
Shoqëria Mane TCI		100 %	
Shoqëria Balfin	100 %		
Total	100.00%	100.00%	



IV. BILANCET NË CELJE DHE NË MBYLLJE TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Bashkimi me përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të Mane TCI shpk dhe Skënderbej shpk të datës së mbylljes (Data e Fundit Kontabël).

Data e Mbylljes do të jetë data e miratimit final të marrëveshjes së përthithjes.

Data e Ekzekutimit do të jetë data e regjistrimit të bashkimit me përthithje të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në rastin ideal, data e mbylljes dhe ajo e ekzekutimit do të jenë të njëjtat ose do të kenë një diferencë shumë të shkurtër në ditë.

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse (Mane TCI shpk) do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës së Mbylljes, bazuar në informacionet kontabel të të dy shoqërive përpara përthithjes, në këtë datë.

V. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUESHME

Në bazë të nenit 215, pikal e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë së përthithur Skënderbej shpk, sipas Bilancit të Datës së Fundit Kontabël, do të transferohen tek shoqëria përthithëse, Mane TCI shpk.

Aktivet dhe pasivet e transferuara janë ato që përcaktohen në Bilancin Kontabël të datës 30.04.2019 si dhe cdo ndryshim i ndodhur në librat kontabël nga kjo date deri në datën e fundit kontabël (data e mbylljes së bashkimit me përthithje). Aktivet dhe pasivet e transferuara përfshijnë gjithashtu cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare, bazën e të dhënave të klientëve, të mardhenieve me shtetin, me furnitorët, si dhe cdo marrëdhënie tjetër kontraktore në fuqi.

Me transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, Mane TCI shpk do të marrë në posedim të gjithë evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet dhe dokumenta të tjerë për të provuar ekzistencën e të drejtave

dhe detyrimeve që transferohen, si dhe faturën tregtare që lëshohet për dokumentimin e vlerave përmbledhese të transferuara dhe evidencën mbështetëse të këtyre vlerave në datën e mbylljes,

Për aktive/detyrime të caktuara për transferimin e të cilave mund të nevojitet miratimi i një pale të tretë, do të merret paraprakisht ky miratim.

Mane TCI shpk do të njoftojë të gjithë klientët e Skënderbej shpk për transferimin e kontratave, të drejtave dhe detyrimeve të rrjedhura prej tyre drejt Mane TCI shpk si pasojë e bashkimit me përthithje.

Të drejta dhe detyrime të ndërsjellta ndërmjet Mane TCI shpk dhe Skënderbej shpk, në zbatim të SNK ne fuqi, do të mbyllen dhe nuk paraqiten në bilancin e konsoliduar të përgatitur në datën e transferimit (mbylljes së procesit). Në datën e hartimit të këtij dokumenti, por edhe në datën 31.12.2018, shoqëria "Skenderbej" Sh.p.k. nuk dispononte pasuri të paluajtshme dhe as inventarë qarkullues.

VI. RAPORTI I KËMBIMIT TË KUOTAVE

Raporti i këmbimit nënkupton vlerën e kapitalit që do të duhet të emetohet nga Mane TCI shpk në këmbim të të drejtave dhe detyrimeve të transferuara nga Skënderbej shpk, por që në rrethanat e këtij transaksioni nuk është e aplikueshme.

Në përputhje me natyrën e transaksionit dhe në kushtet që shoqëria "MANETCI" Sh.p.k. është zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë "Skenderbej" Sh.p.k., pra ortak i vetëm i kësaj shoqërie, nuk është e zbatueshme dispozita për kalkulimin e raportit të këmbimit të kuotave të shoqërive të përfshira në bashkim, me qëllim pagesën e ortakëve të shoqërisë që përthithet, pasi "MANETCI" Sh.p.k. ishte dhe mbetet ortak i vetëm i shoqërisë së përthithur apo i pasurisë së përthithur. Meqenëse shoqëria e përthithur është një shoqëri e kontrolluar 100% nga shoqëria përthithëse, bashkimi i shoqërisë mëmë me njësinë e kontrolluar plotësisht prej saj nuk është një kombinim biznesi, pasi shoqëria mëmë dhe njësia e kontrolluar prej saj përbënin një njësi të vetme ekonomike, edhe para se ato të bashkoheshin.

VII. KUOTAT E SHOQËRISË PËRTHITHËSE

Referuar përcaktimit në pikën VI më sipër, shoqëria "MANETCI" Sh.p.k. nuk ka detyrim për të emetuar kapital, pasi ajo është vetë zotëruese e kapitalit të shoqërisë së përthithur, kapital i cili së bashku me rezervat dhe një pjesë të fitimit të pashperndare, në konsolidim do të mbyllen nga vlera e investuar nga kjo kompani (vlera e paguar në datën e blerjes) referuar Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr.3, Kombinimet e Biznesit. Pra vlera e regjistruar e kapitalit të shoqërisë "MANETCI" Sh.p.k., pas bashkimit do të jetë 689,750,000 Lekë, aq sa ishte para bashkimit. Struktura e ortakërisë mbetet e pandryshuar, ajo është e njëjte me atë para bashkimit.

VIII. PASQYRAT FINANCIARE PAS BASHKIMIT

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse është bilanci i konsoliduar në datën e fillimit të procedurës së bashkimit (30.04.2019), i përgatitur në bazë të informacioneve kontabël të dy shoqërive në fjalë, ndërsa bilanci final do të përgatitet në datën e fundit kontabël, në bazë të vlerës finale të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara. Pasqyrat Financiare të Celjes dhe të mbylljes së procesit, do të përgatiten në bazë të parimeve të konsolidimit të pasqyrave financiare në datën raportuese.

Tabela1 - Pasqyra e Pozicionit financiar te konsoliduar në datën e fillimit të procedurës

MANE TCI Sh.p.k. (pas bashkimit)
Pasqyra e Pozicionit Financiar e konsoliduar
Date 30 Prill 2019
Në Lekë

Shënime	Mane TCI sh.p.k.	Skenderbej sh.p.k.	Veprime konsolidimi	Mane TCI sh.p.k. pas bashkimit
AKTIVE				
Aktive afatgjata				
Aktive afatgjata materiale	118,472,223	-	-	118,472,223
Aktive afatgjata financiare	147,590,005	186,003,530	-	333,593,535
Inventari	131,657,360	-	-	131,657,360
Aktive te mbajtura per nxjerje j. perdorimi	53,068,722	-	(52,558,722)	510,000
Aktiv tatimor i shtyre	4,912,082	2,013,853	-	6,925,935
Total Aktive Afatgjata	455,700,393	188,017,383	(52,558,722)	591,159,054
Aktive afatshkurtra				
Inventari	1,700,567,676	-	-	1,700,567,676
Kredi me interes dhe huadhenie afatshkurter	29,357,175	-	-	29,357,175
Te drejta te arketueshme	1,914,582,781	1,475,404	(70,222,809)	1,845,835,376
Aktive nga Kontratat	76,426,816	-	-	-
Aktive afatshkurte te tjera	913,355,598	-	(28,913,945)	884,441,653
Tatim fitimi i parapaguar	2,618,968	1,175,843	-	3,794,811
Mjete monetare dhe te ngjashme	48,291,299	731,650	-	49,022,949
Total Aktive Afatshkurtra	4,685,200,312	3,382,897	(99,136,754)	4,513,019,640
TOTAL AKTIVE	5,140,900,705	191,400,280	(151,695,476)	5,104,178,694
KAPITALI DHE DETYRIMET				
Kapitali				
Kapitali	689,750,000	21,832,888	(21,832,888)	689,750,000
Rezerva	-	17,879,232	(17,879,232)	-
Fitimi mbartur	1,053,629,287	52,114,346	(12,846,602)	1,092,897,031
Total Kapitali	1,743,379,287	91,826,466	(52,558,722)	1,782,647,031
Detyrime Afatgjata				
Kredi me interes dhe huamarrje	296,424,441	-	-	296,424,441
Detyrime te tjera financiare	35,702,429	-	-	35,702,429
Detyrime nga kontratat e Sipërmarrjes	1,582,993,416	-	-	1,582,993,416
Total Detyrime Afatgjata	1,915,120,287	-	-	1,915,120,287
Detyrime Afatshkurtra				
Llogari te pagueshme	947,052,205	70,633,294	(70,222,809)	947,462,690
Te pagueshme te tjera	7,477,299	26,575	-	7,503,874
Kredi me interes dhe huamarrje	527,871,628	28,913,945	(28,913,945)	527,871,628
Detyrime te tjera financiare	-	-	-	-
Tatim fitimi i pagueshem	-	-	-	-
Total Detyrime Afatshkurtra	1,482,401,131	99,573,814	(99,136,754)	1,482,838,191
Total Detyrime	3,397,521,418	99,573,814	(99,136,754)	3,397,958,478
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET	5,140,900,705	191,400,280	(151,695,476)	5,180,605,510

Tabela 2 – Kapitali date 30.04.2019

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përthithëse, i cili ishte dhe mbetet i pandryshuar, detajohet sipas tabelës së mëposhtme:

Kapitali i "Mane TCI" sh.p.k.	Para bashkimit me përthithje	Rritja e kapitalit	Pas bashkimit me përthithje
Ortak 100% shoqëria "Balfin" sh.p.k.	689,750,000	0	689,750,000
Numri i kuotave	1	0	1

Ndërsa Kapitali në total i shoqërisë përthithëse, pas konsolidimit, në datën e fillimit të procedurës së bashkimit (30.04.2019), detajohet sipas tabelës së mëposhtme:

Kapitali me date 30.04.2019	Mane TCI sh.p.k.	Skenderbej sh.p.k.	Veprime konsolidimi	Kapitali total pas përthithjes
Kapitali	689,750,000	21,832,888	(21,832,888)	689,750,000
Rezerva	-	17,879,232	(17,879,232)	-
Fitimi mbartur	1,053,629,287	52,114,346	(12,846,602)	1,092,897,031
Total	1,743,379,287	91,826,466	(52,558,722)	1,782,647,031

- Theksojmë që, sikurse kemi shkjaruar më sipër, zëri i Kapitalit të Ortakut të vetëm, shoqërisë BALFIN sh.p.k. do të mbetet me vlerën që kishte para bashkimit me përthithje, pra 689 750 000 Lekë;
- Ekzistojnë të drejta dhe detyrime të shoqërisë Mane TCI sh.p.k. dhe Skenderbej sh.p.k. kundrejt njëra-tjetrës, balancat e të cilave shuhen në Bilancin e Çeljes së Shoqërisë Përthithëse. Këto veprime janë paraqitur në shënimin nr.2 dhe 3 të tabelës nr.1;
- Aktivët dhe detyrimet tatimore të shoqërisë Skënderbej shpk transferon tek shoqëria përthithëse. Më 30 Prill 2019, shoqëria Skënderbej shpk ka një balancë të Tatim Fitim të mbipaguar prej 1,175,843 Lekë, detyrim për Tatim mbi paga prej 10 197 Lekë si dhe detyrim për sigurimet shoqërore me vlerë 16,379 Leke, të cilat janë paguar gjatë muajit Maj 2019. Te drejta apo detyrime të tjera që mund të krijohen dhe mbeten të tilla deri në datën e transferimit, i transferohen shoqërisë përthithëse e cila merr përsipër dhe garanton mbylljen e tyre.
- Shoqëria Skënderbej shpk, sipas pasqyrave financiare të 30.04.2019, transferon mjete monetare, të drejta të arkëtueshme ndaj klientëve dhe shtetit për tatim fitimi dhe detyrime ndaj furnitoreve, si dhe llogaritë e mardhënieve të ndërsjellta. Vlerat e këtyre llogarive mund të ndryshojnë deti në datën e mbylljes së përthithjes.
- Të gjitha ndryshimet në pasqyrat financiare të shoqërisë së përthithur deri në datën e mbylljes të bashkimit me përthithje, të cilat sjellin ndryshimin e Bilancit të Çeljes së shoqërisë përthithëse, do të raportohen nga administratorët dhe do të miratohen Asambleja e Ortakut të Vetëm, në datën e miratimit të bashkimit.

- Pasqyrat e konsoliduara janë përgatitur me supozimin e transferimit të këtyre të drejtave dhe detyrimeve tek Mane TCI shpk.
- Theksojmë që nuk ka nevojë për licënsa specifike në lidhje me aktivitetin që do të transferohet, pasi ekzistojnë vetëm të drejta për tu arketuar dhe detyrime të pagueshme, ndërsa veprimtaria operationale e qiradhënies ka përfunduar, pas shitjes së pasurive që ishin dhënë me qira. Shoqëria ka manaxhuar me kujdes procesin e mbylljes së kontratave të qirasë, duke mos mos patur kosto shtesë nga ky proces.

IX. TË DREJTA TË VECANTA

Transferimi nuk prek të drejta të vecanta të Ortakut, pasi në statut nuk ka të tilla. Ortaku i vetëm do të vazhdojnë të gezojnë të njëjtat të drejta edhe pas bashkimit me përthithje.

X. KUSHTE TË TJERA PARAPRAKE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

Në mënyrë që të garantohet vijimësia e suksesshme dhe pa ndërprerje e aktivitetit tregtar brënda strukturës së Mane TCI shpk, **para datës së mbylljes** (data e miratimit final të marrëveshjes së bashkimit me përthithje) duhet të plotësohen dhe krijohen një sërë kushtesh të cilat do të lejojnë ushtrimin e këtij aktiviteti nga ana operationale:

i. Inventarizimi fizik i pasurisë

Aktualisht në pronësi të Skënderbej shpk nuk ka në pronësi as aktive afatgjata materiale dhe as inventarë qarkullues.

ii. Organigrama e Re

Deri në datën e mbylljes së bashkimit, strukturat përgjegjëse të dy shoqërive do të vazhdojnë punën pa asnjë ndryshim. Gjatë periudhës tranzitore deri në datën e miratimit të bashkimit, do të bëhet rregullimi i funksioneve drejtuese duke përcaktuar organigramën e re si dhe do të përgatiten përshkrimet e punës si dhe kontratat e punës së punonjësve që do të transferohen (në zbatim të pikës X të këtij raporti).

iii. Plani Operacional dhe Pritshmëritë Ekonomike

Menjëherë pas nënshkrimit të projekt-marrëveshjes dhe para ekzekutimit të bashkimit do të hartohet një plan operacional i cili do të shpjegojë se si do të integrohet aktiviteti i transferuar. Do të hartohen/modifikohen projeksionet financiare të shoqërisë duke konsideruar impaktin e ndryshimit të pritshëm.

iv. Statuti i Ndryshuar

Para datës së regjistrimit të bashkimit në QKR, Departamenti Ligjor të bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme (nëse duhet) në statutin e shoqërisë për ta përshatur më ndryshimet dhe për të qënë i vlefshëm për shoqërinë përthithëse.

10 | F a q e

v. Njoftimi dhe/ose Marrja e Pëlqimit nga Palë të Treta

Para datës së regjistrimit të bashkimit në QKB, Mane TCI shpk dhe Skënderbej shpk do të njoftojnë palët e treta (klientët dhe furnitorët) dhe ose do të marrin pëlqimin e tyre për transaksionin e bashkimit nëse diçka e tillë është e parashikuar në kontratat në fuqi me këto palë.

Përveç detyrimeve kontraktuale për të cilat kërkohet pëlqim, palët kanë detyrim ligjor të njoftojnë **organet tatimore**, të marrin aprovimin e **Autoritetit të Konkurrencës**.

XI. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT

Në datën e regjistrimit të bashkimit në QKB, të gjitha kontratat e punës së punëmarrësve të Skënderbej shpk në fuqi do të transferohen pranë Mane TCI shpk, në përputhje me Nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës. Mane TCI shpk do të marrë përsipër të gjithë kontratat e punës të punëmarrësve të Skënderbej shpk dhe do të konsiderohet pala përgjegjëse për çdo detyrim të pashlyer nga Skënderbej shpk para datës së ekzekutimit.

XII. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE TË MANE TCI SHPK PËRTHITHJES

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të Mane TCI shpk. Në datën e ekzekutimit të bashkimit, anëtarët e organeve drejtuese të Mane TCI shpk do të konsiderohen anëtarët e organeve të shoqërisë përthithëse. Organet drejtuese të Skënderbej shpk do të japin dorëheqjen në Datën së Ekzekutimit.

XIII. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT

Sikurse parashikon neni 220, pika 3, e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit:

a) ka pasojë kalimin të shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet.

Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe të palët e treta;

b) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personalitet juridik do të vazhdojë të ketë vetëm shoqëria përthithëse Mane TCI shpk.

Ky raport përgatitet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive Mane TCI shpk dhe Skënderbej shpk në vijim të autorizimit nga Asambleja e Ortakut të Vetem të shoqërive përkatëse :

MANE TCI SHPK

Përfaqësues Ligjor

Tiranë, më 20.06.2019

**SKËNDERBEJ SHPK**

Përfaqësues Ligjor

